VENDIM
Nr. 16, datë 11.1.2017

PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN E INTERKONEKTORËVE TË RINJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kushteve dhe të procedurave për ndërtimin e interkonektorëve të rinj, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR NDËRTIMIN E INTERKONEKTORËVE TË RINJ

I. Objekti

1. Këto rregulla do të zbatohen për ndërtimin e interkonektorëve të rinj me tension të barabartë ose më të lartë se 110 kV, të cilët ndërtohen për t'u lidhur me rrjetet e shteteve fqinje.

2. Ndërtimi i interkonektorit të ri nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), ose nga investitorët privatë, realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat, siç janë parashikuar në këtë vendim.

II. Ndërtimi i interkonektorëve të rinj nga Operatori i Sistemit të Transmetimit

1. Ndërtimi i interkonektorëve të rinj nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), miratohet kur plotësohen këto kritere të përgjithshme:

a) është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë;

b) është në përputhje me strategjitë e miratuara nga qeveria për zhvillimin e rrjetit kombëtar të energjisë;

c) është pjesë e planit pesë vjeçar të zhvillimit të rrjetit, të miratuar nga ERE;

ç) të jetë kryer një studim fizibiliteti që provon nevojën dhe mundësinë e realizimit të ndërtimit të kësaj linje;

d) të jetë nënshkruar një marrëveshje ndërmjet qeverive të të dyja vendeve fqinje, të cilat do të lidhen me këtë linjë.

2. Ministria, pas marrjes së propozimit të OST-së, verifikon përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në pikën 1, të këtij seksioni dhe i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e ndërtimit të interkonektorit.

III. Ndërtimi i interkonektorëve të rinj nga investitorët privatë

Ndërtimi i interkonektorëve të rinj nga investitorët privatë miratohet kur plotësohen këto kritere të përgjithshme:

a) për ndërtimin e interkonektorit të ri është realizuar nga investitori një studim fizibiliteti që provon nevojën dhe interesin për ndërtimin e kësaj linje;

b) ndërtimi i interkonektorit të ri nuk ndikon në stabilitetin dhe sigurinë e rrjetit kombëtar të energjisë;

c) interkonektori zotërohet nga një person juridik, ligjërisht i ndarë nga OST-ja;

ç) të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe lidhjen e interkonektorit të ri me sistemin e transmetimit mbulohen nga investitori;

d) investitori bie dakord se një pjesë e kapacitetit të interkonektorit të ri, siç përcaktohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), do të shërbejë për përdorim publik nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;

dh) investitori bie dakord, paraprakisht, për kushtet dhe kohëzgjatjen e përcaktuar nga ERE, për përjashtimin nga aksesi të palës së tretë dhe funksionimin e interkonektorit gjatë periudhës së përjashtimit;

e) operimi i interkonektorit të ri bëhet nga OST-ja, sipas dispozitave të kodit të funksionimit të rrjetit dhe të rregullave të tregut;

ë) mirëmbajtja e interkonektorëve të rinj është përgjegjësi e investitorit privat për të gjithë periudhën që zotëron këtë linjë;

f) pjesë e kapacitetit të interkonektorit të ri, që përdoret për interes publik, do të shpërndahet në përputhje me vendimet e ERE-s.

IV. Rregulla të përgjithshme për ndërtimin e interkonektorëve të rinj nga investitorët privatë

1. Ndërtimi i interkonektorëve të rinj nga investitorët privatë miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe industrinë.

2. Shoqërive të cilave iu është dhënë miratimi nga Këshilli i Ministrave për ndërtimin e interkonektorit të ri, mund të aplikojnë pranë ERE-s, për përjashtimin nga rregullat për aplikimin e "të drejtës së aksesit të palëve të treta", në përputhje me ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë".

3. Interkonektorët e rinj me rrymë të vazhduar, sipas kërkesës, përjashtohen, për një periudhë kohe të kufizuar, nga aksesi i palëve të treta, sipas kushteve të mëposhtme:

a) investimi përmirëson konkurrencën në furnizimin e energjisë elektrike;

b) niveli i riskut, lidhur me investimin, është i tillë që investimi nuk do të mund të kryhej nëse nuk jepet përjashtimi nga detyrimi për t'u siguruar të drejtë aksesi palëve të treta;

c) interkonektori është pronë e një personi juridik, i cili është i ndarë, nga pikëpamja ligjore, nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;

ç) ndaj përdoruesve të interkonektorit aplikohen pagesa për shfrytëzimin e kapaciteteve të tij;

d) asnjë pjesë e kapitalit ose kostove operacionale të interkonektorit nuk është mbuluar prej ndonjë komponenti tarifash, të aplikuara ndaj përdorimit të rrjetit të transmetimit apo shpërndarjes, të lidhur nga interkonektori; dhe

dh) përjashtimi nga detyrimi për t'u siguruar të drejtë aksesi palëve të treta nuk dëmton konkurrencën ose funksionimin efektiv të tregut të brendshëm apo të tregut të vendit tjetër, me të cilin është lidhur interkonektori.

V. Kushtet për ndërtimin e interkonektorit të ri me rrymë të vazhduar

1. Shoqëritë që nuk janë të licencuara nga ERE për zhvillimin e aktivitetit të transmetimit ose të shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilat duan të realizojnë me shpenzimet e tyre interkonektorë të rinj me rrymë të vazhduar, të lidhur me rrjetet e shteteve të tjera, duhet të depozitojnë pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë, në vijim Ministria, kërkesën për ndërtimin e interkonektorit të ri.

2. Kërkesa për ndërtimin e interkonektorëve të rinj duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) datën e parashikuar për fillimin e punimeve dhe datën e fillimit të funksionimit të linjës së interkonektorit të ri;

b) karakteristikat kryesore teknike të interkonektorit të ri;

c) kapacitetin neto të transmetimit;

ç) përcaktimin e viteve për të cilat kërkohet afati i ndërtimit;

d) analizat ekonomike dhe financiare të interkonektorit të ri;

dh) angazhimin për respektimin e kodit të transmetimit dhe çdo rregull tjetër teknik të OST-së që garanton qëndrueshmërinë dhe sigurinë e operimit të Sistemit Kombëtar të Energjisë gjatë periudhës së ndërtimit dhe funksionimit të interkonektorit të ri;

e) angazhimin për të filluar punën sipas planit;

ë) projektin paraprak të interkonektorit të ri;

f) angazhimin për të ndërtuar interkonektorin e ri brenda termave dhe kushteve të përcaktuara në projekt;

g) paraqitjen e një deklarate që dëshmon se në një situatë mbingarkese sistemi, me miratimin e ERE-s, t'i sigurojë OST-së, pa pagesë, kapacitetin e nevojshëm për funksionim;

gj) transferimin e aseteve në pronësi të OST-së, në fund të periudhës për të cilën është dhënë leja për përjashtimin nga aksesi të palëve të treta;

h) angazhimin se në situatat e përcaktuara nga legjislacioni përkatës, do të veprojë në përputhje me detyrën e shërbimit publik.

3. Kërkesa për ndërtim duhet të ketë bashkëngjitur të gjitha aplikimet për autorizimet e ndërtimit të interkonektorit të ri në territorin e vendit tjetër.

4. Nëse dokumentacioni nuk është i plotë, ministria i kërkon aplikantit ta plotësojë atë brenda 60 ditëve kalendarike. Pas mbarimit të këtij afati, në rast se dokumentacioni nuk është i kompletuar, kërkesa konsiderohet e refuzuar.

VI. Kushtet për ndërtimin e interkonektorit të ri me rrymë alternative

1. Shoqëritë që nuk janë të licencuara për zhvillimin e aktivitetit të transmetimit ose të shpërndarjes, të cilat duan të ndërtojnë me shpenzimet e tyre interkonektorë të rinj me rrymë alternative, të lidhur me rrjetet e shteteve të tjera, duhet të aplikojnë në Ministri, sipas kushteve të parashikuara në paragrafët 2 dhe 3, të seksionit V, të këtij vendimi, së bashku me:

a) dokumentacionin që provon se kostot dhe rreziqet e investimit në fjalë të jenë veçanërisht të larta, krahasuar me kostot dhe risqet e hasura normalisht për lidhjen me rrjetin e transmetimit të një vendi fqinj, nëpërmjet një interkonektori me rrymë alternative;

b) një deklaratë angazhimi për përfshirjen e interkonektorit të ri, nga fillimi i operimit, në rrjetin kombëtar të transmetimit.

2. Në rastet kur aplikimet janë të paplota, do të veprohet në përputhje me pikën 4, të seksionit V.

3. Pika 4, e seksionit IV, do të jetë gjithashtu e aplikueshme ndaj interkonektorëve me rrymë alternative, në raste përjashtimore, duke siguruar që kostot dhe rreziqet e investimit në fjalë të jenë veçanërisht të larta, krahasuar me kostot dhe risqet e hasura normalisht për lidhjen me rrjetin e transmetimit të një vendi fqinj, nëpërmjet një interkonektori me rrymë alternative.

VII. Kushtet dhe procedurat për dhënien e miratimit

1. Përmbushja e kërkesave për dhënien e miratimit, të parashikuara në seksionet V dhe VI, të këtij vendimi, shqyrtohen nga ministria, e cila vendos rast pas rasti nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) funksionimi i një interkonektori të ri garanton kërkesat e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efiçencës së funksionimit të rrjetit kombëtar të transmetimit;

b) funksionimi i interkonektorit të ri duhet të rritë kapacitetin tregtues të importimit dhe eksportimit të energjisë elektrike;

c) funksionimi i interkonektorit të ri promovon konkurrencën në treg;

ç) arrihet një marrëveshje, mes ministrisë dhe autoriteteve kompetente të shteteve të përfshira, rreth metodave të aksesit ose përdorimit të interkonektorit të ri;

d) verifikohet përputhshmëria e interkonektorit të ri me sigurinë dhe qëndrueshmërinë e funksionimit të Sistemit Kombëtar të Energjisë.

2. Ministria vendos për dhënien e një miratimi paraprak, brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës, pas marrjes së mendimit të Entit Rregullator të Energjisë dhe OST-së. Enti Rregullator i Energjisë dhe OST-ja duhet të shprehin mendimin e tyre brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës nga ministria.

3. Miratimi hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me paragrafin 1, të nenit 31, të ligjit nr. 43, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

4. Ndërtimi i interkonektorit të ri, i miratuar nga Këshilli i Ministrave, përmban detyrimet që duhet të respektohen nga aplikuesi lidhur me:

a) investimet në rrjetin ekzistues të transmetimit, që duhen bërë nga investitori për zbatimin e interkonektorit të ri;

b) garancitë përkatëse financiare;

c) rastet e revokimit të miratimit.

5. Miratimi revokohet nëse shoqëria nuk përmbush detyrimet në lidhje me datën e fillimit të

punimeve ose për dështimin e realizimit të projektit në kohë.

VIII. Dispozita të fundit

1. Mbajtësi i miratimit të ndërtimit të interkonektorit të ri, në çdo rast para fillimit të punimeve, hyn në një kontratë me OST-në, për ndërtimin dhe funksionimin e interkonektorit të ri, ku rregullohen të gjitha aspektet e marrëdhënies së tyre.

2. OST-ja, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe brenda 31 dhjetorit të çdo viti, publikon kapacitetin për të cilin parashikohet ndërtimi për interkonektorët e rinj gjatë vitit të ardhshëm dhe përcakton ndarjen e këtij kapaciteti në zona të ndryshme të vendit. Në publikimin e këtyre kapaciteteve, OST-ja merr parasysh asetet ekzistuese të rrjetit kombëtar të transmetimit.